HEI'25
Higher Education Intervention 2025

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

INTEGRITETI AKADEMIK DHE PUBLIKIMI SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E FERIZAJT



Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6

Autor i përmbajtjes:
Skord Retkoceri

Hartues i raportit:
Rron Gjinovci

Hulumtues:
Dibran Hoxha

Prishtinë, Qershor 2025

"Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s'kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!"

Faik Konica

Përmbajtja

04 **Përmbledhje ekzekutive**

08 **Të dhënat për universitetin**

11 **Publikimi shkencor**
16 - Në cilat kuartale të Scopus-it publikuan stafi?
19 - Shtetet nga ku janë botuesit e revistave
23 - Punimet e vlefshme për avancim

20 **Publikimi në revista dhe botues të dyshimtë**

21 **Justifikimi i titujve akademikë**

33 **Metodologjia**

Përmbledhje Ekzekutive

[Përmbledhja e gjeneruar nga ChatGPT]

"Gjenero një përmbledhje ekzekutive të raportit hulumtues të bashkangjitur, bazuar në të dhënat e paraqitura. (max. 350 fjalë)"

Ky raport analizon gjendjen e integritetit akademik dhe të publikimit shkencor në Universitetin e Ferizajt, duke vlerësuar në mënyrë të detajuar përbërjen e stafit akademik, justifikimin e titujve, cilësinë e publikimeve dhe përputhjen e tyre me standardet e avancimit akademik.

Universiteti ka gjithsej 36 pjesëtarë të stafit akademik, prej të cilëve 28 mbajnë tituj profesorialë dhe 8 janë ligjërues. Në këtë analizë nuk është përfshirë Fakulteti i Arteve të Aplikuara, për shkak të specifikave të veçanta të fushës që nuk lidhen drejtpërdrejt me kriteret e zakonshme të publikimit shkencor në revista të indeksuara.

Gratë përbëjnë vetëm 25% të stafit, por 86% e tyre i justifikojnë titujt akademikë, krahasuar me 52% të burrave, duke reflektuar zbatim më strikt të kritereve ndaj grave. Në total, 61% e stafit me tituj profesorialë justifikojnë titujt e tyre përmes publikimeve të pranueshme në revista të indeksuara në Scopus apo Web of Science.

Stafi ka publikuar gjithsej 82 punime në revista të indeksuara në Scopus, prej të cilave 25 janë edhe në Web of Science. 66 prej tyre janë të vlefshme për avancim akademik, sipas standardit që njeh autorin e parë ose korrespodent.

30% e punimeve janë të botuara në revista të kuartalit të parë dhe të dytë, ndërsa 39% në kuartalin e katërt. Një përqindje e madhe e publikimeve është përqendruar në një revistë të vetme të kuartalit të katërt, duke ngritur shqetësime për koordinim të brendshëm dhe standarde të ulëta të rishikimit shkencor. Për më tepër, 39% e stafit kanë publikuar të paktën një herë në revista me botues të konsideruar si të dyshimtë.

Mesatarja e punimeve për profesorë është 2.4. Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës dhe ai i Turizmit dhe Ambientit kanë performancën më të lartë në publikime për profesor.

Ky raport synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të bazuar në të dhëna për të ndihmuar përmirësimin e praktikave të avancimit akademik dhe të publikimit në Universitetin e Ferizajt, duke kontribuar në ngritjen e integritetit dhe cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.



Të dhëna për universitetin

Universiteti i Ferizajt ka gjithsej 36 pjesëtarë të stafit akademik (pa e llogaritur Fakultetin e Arteve të Aplikuara). 28 janë me tituj profesorialë si profesorë asistentë, të asocuar dhe të rregullt. Për dallim nga universitetet tjera publike në Ferizaj nuk ka asistentë, por vetëm ligjërues.

Universiteti ka vetëm 2 pjesëtarë të stafit akademik në titullin më të lartë akademik atë të profesorit të rregull, 12 në atë të profesorit të asocuar dhe 14 në atë të profesorit asistent. Ndërkaq, 8 pjesëtarë të stafit akademik janë ligjërues.

Numri i stafit akademik sipas fakulteteve

	Profesorët asistentë	Profesorët e asocuar	Profesorët e rregullt	Ligjërues
Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit	2	2	1	4
Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës	3	2	1	2
Fakulteti i Menaxhmentit	6	6	0	0
Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit	3	2	0	2
Të gjitha fakultetet	**14**	**14**	**2**	**8**
	36			


Nga 2 profesorët e rregullt, të dy janë burra, ndërsa nga 12 profesorë të asocuar, 10 janë burra e 2 gra, ndërkohë nga 14 profesorë asistentë, 9 janë burra e 5 gra. Po ashtu, nga 8 ligjërues, 6 janë burra e 2 gra. Në total vetëm 25% e stafit akademik në Universitetin e Ferizajt janë gra.

Numri i stafit akademik sipas gjinisë

	Profesorët e rregullt	Profesorët e asocuar	Profesorët asistentë	Ligjërues	**Total**	
Gra	0	2	5	2	**9**	**25%**
Burra	2	10	9	6	**27**	**75%**
Total	**14**	**14**	**2**	**8**	**36**	**100%**

Publikimi shkencor


Stafi akademik (profesorët dhe ligjëruesit) në Universitetin e Ferizajt kanë publikuar 82 punime shkencore në revista të indeksuara në Scopus. Prej tyre 25 janë në Web of Science, ndërsa 57 janë vetëm në Scopus. Këtu nuk përfshihen punimet në revistat apo botues që janë të listuar si të dyshimtë.



Në Scopus dhe Web of Science
82

Punimi i parë i evidentuar në vitin 2010, është në revistë të indeksuar në Scopus si dhe Web of Science. Vërehet një rritje eksponenciale e punimeve mes vitit 2023 dhe 2024. Ndërkohë që në vitin 2023 kishte 15 punime të publikuara nga stafi akademik i universitetit, në 2024 ky numër është dyfishuar apo parë në krahasim me mesataren e viteve paraprake është trefishuar.

Presioni publik i ushtruar nga raportimet periodike që e vendosnin Universitetin e Ferizajt në fund të rangimit kombëtar të universiteteve duket se ka dhënë rezultatet e veta dhe universiteti ka përmirësuar performancën e tij.




Prej 82 punimeve, 9 janë nga revista të larguara nga Scopus në vite të ndryshme. 9 profesorë kanë publikuar në revista të tilla. Revistat largohen nga Scopus nëse pas një rivlerësimi periodik vërehen probleme me cilësinë e përmbajtjes, mungesë të praktikave të besueshme editoriale apo shkelje të standardeve etike të publikimit.

Ajo që mund të vërehet është se vitet kur pjesëtarët e stafit akademik kanë publikuar në revistat në fjalë janë të afërta me vitin e përjashtimit të tyre nga indeksimi. Kjo ngre dyshime për zbulimin e praktikave të dyshimta të revistave në fjalë me ç'rast pjesëtarët e stafit akademik kanë shfrytëzuar mundësinë për publikim në to.

Punime të publikuara në revista të përjashtuara nga Scopus për çështje cilësie

Revista ku ndodhet punimi	Viti i publikimit të punimit	Viti i fundit i indeksimit në Scopus
Fresenius Environmental Bulletin	2017	2021
International Journal of Economics and Business Administration	2020	2020
International Journal of Advanced Science and Technology	2020	2020
Journal of Liberty and International Affairs (2 punime)	2022	2023
Corporate Governance and Organizational Behavior Review	2022	2024
International Journal of Applied Economics, Finance and Accounting	2023	2023
Review of Economics and Finance	2023	2024
Nurture	2024	2024

Punime të publikuara në revista të përjashtuara nga Scopus për çështje cilësie - Universiteti i Ferizajt




- Nurture
- Review of Economics and Finance
- International Journal of Applied Economics, Finance and Accounting
- Corporate Governance and Organizational Behavior Review
- Journal of Liberty and International Affairs (2 punime)
- International Journal of Advanced Science and Technology
- International Journal of Economics and Business Administration
- Fresenius Environmental Bulletin


Viti i publikimit të punimit Viti i fundit i indeksimit në Scopus

Në cilat kuartale të Scopus-it publikuan stafi?

Kualiteti i revistave të indeksuara në Scopus, në të cilat publikon stafi akademik i universiteteve publike tregohet përmes rangimit të tyre në kuartale indeksimi. Kuartali i parë dhe i dytë garantojnë cilësi ndërkaq i treti dhe i katërti nuk janë garantues të cilësisë meqë në të kaluarën vet ORCA ka adresuar probleme të praktikave të dyshimta të revistave të indeksuara në Scopus të cilat pas denoncimeve të ORCA-s ose janë larguar nga indeksimi në Scopus ose janë futur në listën e zezë të universiteteve pubike.



30% e punimeve të publikuara në revista të indeksuara në Scopus u takojnë kuartaleve një dhe dy, çka e bën të kënaqshëm peisazhin e publikimit shkencor në Universitetin e Ferizajt.



Kuartalet në Scopus dhe ndërlidhja me Web of Science


Rëndom, revistat e indeksuara në Scopus në kuartalet një dhe dy, janë të indeksuara edhe në Web of Science çka e rritë garancinë e kualitetit të tyre të procesit "peer review". Mund të ndodhë që edhe revistat e e kuartalit të tretë të kenë indeksim në Web of Science, por ndodh rrallë apo fare që revistat e kuartalit të katërt të kenë indeksim në Web of Science. Si rrjedhojë edhe ndërprerja e indeksimit nga Scopus ndodh zakonisht me revistat e indeksuara në kuartalin e katërt. Siç mund të vërehet nga të dhënat 39% të të gjitha punimeve të stafit akademik të Universitetit të Ferizajt të indeksuara në Scopus i takojnë kuartalit të katërt.

	Numri i punimeve në Scopus	Prej tyre në Web of Science
Kuartali 1	11	7
Kuartali 2	14	12
Kuartali 3	16	6
Kuartali 4	32	0
Pa kuartal*	9	0


*Punimet e përjashtuara nga Scopus nuk janë në asnjë kuartal

Shtetet nga ku janë botuesit e revistave


Stafi akademik në këtë universitet ka publikuar në revista të botuesve nga 21 shtete të ndryshme. Më shumë se një e katërta e të gjitha publikimeve (29%) janë në revista me botues nga Rumania.



Shtetet e botës nga ku janë botuesit e revistave ku kanë publikuar stafi në Universitetin e Ferizajt



Shtetet e Evropës nga ku janë botuesit e revistave ku kanë publikuar stafi në Universitetin e Ferizajt




26% e të gjitha punimeve (21) të publikuara nga stafi akademik në këtë universitet janë të publikuara në revistën 'Quality-Access to Success' nga botuesi 'Romanian Society for Quality Assurance (SRAC) nga Romania. Këto punime janë nga 12 profesorë. 8 prej tyre janë autorë të parë ose korresponentë në këto punime. Një profesor i asocuar prinë me punime në këtë revistë. Ai figuron si autor në 17 prej tyre, 9 prej të cilave si autor i parë ose korrespodent.

Këto të dhëna ngrenë dyshime për organizim në grup të stafit akademik për të publikuar në këtë revistë të indeksuar në Scopus në kuartalin e katërt, e cila mund të mos jetë duke realizuar në përpikmëri procesin "peer review" apo duke bërë lëshime në kurriz të cilësisë.



Punimet e vlefshme për avancim

Nga 82 punime, 66 prej janë të vlefshme për avancim, që do të thotë se stafi akademik i Universitetit mund t'i përdorë për avancim akademik. Të gjitha janë të indeksuara në Scopus, 48 prej tyre vetëm në Scopus ndërsa 18 edhe në Web of Science. Në të gjitha analizat statistikore janë përjashtuar punimet e publikuara në revista ose nga botues të listuar si të dyshimtë.



Në Scopus dhe Web of Science
66

8 prej tyre apo 12% mund të përdoren nga dy anëtarë të stafit për avancim akademik, njëri si autor i parë dhe tjetri si korrespodent. Në rrethanë hipotetike, 16 pjesëtarë të stafit akademik do të mund të avancoheshin në ndonjë nga universitetet publike të Kosovës me këto punime.

Megjithatë rregullorja e këtij universiteti është e vetmja që e njeh vetëm autorin e parë si kategori për avancim. Punimet në radhë të tjera të autorësisë sipas rregullores së Universitetit të Ferizajt nuk vlejnë në procesin e avancimeve akademike të këtij universiteti.

Mesatarja e punimeve është 1.8 punime për staf akademik, në këtë numër përfshihen edhe ligjëruesit për emërimin e të cilëve nuk kërkohen punime shkencore. Po të hiqen nga kalkulimet ligjëruesit, atëherë mesatarja e punimeve për profesor është 2.4.

Prijnë Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës me 24 punime total (4 punime për profesor) si dhe ai i Turizmit dhe Ambientit me 20 punime total (4 punime për profesor). Më i dobëti mbetet Fakulteti i Arkitekturës me 6 punime total (1.2 punime për profesor).

Numri i punimeve të vlefshme për avancim

	Numri i profesorëve	Numri i punimeve	Numri i punimeve për profesor
Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës	6	24	4
Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit	5	20	4
Fakulteti i Menaxhmentit	12	17	1.4
Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit	5	6	1.2
Në nivel universiteti	**28**	**66***	**2.4**

* Njëri nga punimet ka njërin profesor si autor i parë nga Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit dhe njërin si korrespodent nga Fakulteti i Menaxhmentit.

6 profesorë apo rreth 17% nuk e kanë asnjë punim të vlefshëm për avancim akademik, pra si autor i parë ose korrespodent. 3 prej tyre nuk figurojnë si autor në asnjë punim shkencor, në çfarëdo radhe.

Ndarja e 28 profesorëve sipas numrit të punimeve të vlefshme për avancim




Publikimi në revista dhe botues të dyshimtë

14 punime janë të publikuara në 7 revista me botues të listuar si të dyshimtë. Këto revista kanë qenë të indeksuara në Scopus në kohën e publikimit, por 3 prej revistave (gjithsej 6 punime) janë të larguara për çështje të cilësisë në 2016, 2023 dhe 2024.

Asnjë punim në revista të indeksuara në Web of Science nuk është e listuar si e dyshimtë.

Numri i punimeve të revista dhe botues të dyshimta përgjatë viteve



13 profesorë dhe 1 ligjërues, apo 39% e stafit akademik, kanë publikuar të paktën një herë në revistë me botues të dyshimtë. Tek stafi me tituj profesorialë kjo përqindje është 46%.



Justifikimi i titujve akademikë

Justifikimi i titujve sipas metodologjisë që njeh vetëm punimet e autorit të parë ose korrespodent të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara në Web of Science ose në Scopus, është pjesërisht i kënaqshëm me 61% të pjesëtarëve të stafit akademik me tituj profesorialë të cilët i justifikojnë titujt e tyre akademikë.

Me përjashtim të fakultetit të arkitekturës ku rezultati prej 60% është në favor të atyre që **nuk** i justifikojnë titujt e tyre akademikë, në fakultetet tjera rezultati është i barabartë ose në favor të atyre që i justifikojnë titujt akademikë që kulmon me Fakultetin e Turizmit dhe Ambientit në të cilin të pesë profesorët e tij i justifikojnë titujt e tyre akademikë.

79% e profesorëve asistentë i justifikojnë titujt akademikë dhe 50% e profesorëve të asocuar, ndërsa asnjë profesor i rregullt nuk e justifikon titullin.

Justifikimi i titujve akademikë sipas fakulteteve dhe titujve akademikë

	Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Të gjithë profesorët	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit	1	1	1	1	0	1	2 40%	3 60%
Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës	3	0	1	1	0	1	4 67%	2 33%
Fakulteti i Menaxhmentit	4	2	2	4	0	0	6 50%	6 50%
Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit	3	0	2	0	0	0	5 100%	0 0%
Të gjitha fakultetet	**11 79%**	**3 21%**	**6 50%**	**6 50%**	**0 0%**	**2 100%**	**17 61%**	**11 39%**

Trendi i diskriminimit për gratë në akademi vazhdon edhe në këtë universitet. Nga të dhënat e mbledhura vërehet që 86% e grave i justifikojnë titujt e tyre akademikë, krahasuar me 52% të burrave që i justifikojnë titujt e tyre akademikë. Kjo tregon se diskriminimi sistemik ndaj grave bën që rregullat e vendosura të aplikohen në mënyrë më strikte për gratë në akademi sesa për burrat. Ndonëse kjo në pamje të parë është një formë diskriminimi, në të ardhmen kjo do të bëjë që gratë të jenë më kompetente akademikisht dhe në një situatë ku ligjet zbatohen me përpikëri, gratë do të mund të jenë në udhëheqje absolute të arsimit të lartë në Kosovë.

Megjithatë mbetet shqetësuese që rreth 40% e stafit akademik me tituj profesorialë në Universitetin e Ferizajt nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë.


Justifikimi i titujve akademikë sipas gjinisë dhe titujve akademikë

	Profesorët asistentë		Profesorët e asocuar		Profesorët e rregullt		Të gjithë profesorët	
	✓	✗	✓	✗	✓	✗	✓	✗
Gra	4	1	2	0	0	0	6 86%	1 14%
Burra	7	2	4	6	0	2	11 52%	10 48%
Total	**11**	**3**	**6**	**6**	**0**	**2**	**17 61%**	**11 39%**

Gratë



Burrat





Metodologjia

Përzgjedhja e stafit akademik

Në muajin dhjetor të vitit 2024 është gjeneruar lista e stafit akademik për secilin fakultet nga uebfaqja zyrtare e Universitetit të Ferizajt. Për shkak të specifikave të Fakultetit të Arteve të Aplikuara, ky fakultet është përjashtuar nga analiza.

Mbledhja e punimeve shkencore

Gjatë muajit janar të vitit 2025, për secilin anëtar të stafit akademik (profesor i rregullt, i asocuar, asistent dhe ligjërues), është krijuar një databazë me punimet shkencore:

- Nëse anëtari i stafit kishte profil në Google Scholar, janë marrë të gjitha punimet nga ky profil.
- Nëse nuk kishte profil, është bërë kërkim me emër në Google Scholar dhe janë përzgjedhur 50 punimet e para për secilin.

Përpunimi i të dhënave bibliografike

Për çdo punim janë evidentuar dhe analizuar këto të dhëna:

- Titulli i punimit, autorët, viti i publikimit, emri i revistës, identifikuesi unik (DOI), botuesi dhe renditja e autorit.
- Numrat ISSN të revistës dhe lloji i publikimit.
- Është kontrolluar nëse revista apo botuesi janë të listuar si të dyshimtë (sipas listës së Beall-it).

Verifikimi i indeksimit

- Është kontrolluar nëse revista ishte e indeksuar në Scopus në vitin e publikimit të punimit.
- Është verifikuar gjithashtu nëse revista bënte pjesë në një nga tre koleksionet kryesore të Web of Science: Science Citation Index Expanded (SCIE), Social Sciences Citation Index (SSCI) dhe Arts & Humanities Citation Index (AHCI).
- Janë shënuar rastet kur revista ishte larguar nga Scopus për arsye të cilësisë.

Përzgjedhja e punimeve të vlefshme për avancim

Janë konsideruar të vlefshme vetëm ato punime që:

- Janë artikuj shkencorë të botuar në revista që ishin të indeksuara në Web of Science ose në Scopus në kohën e publikimit.
- Nuk janë publikuar në revista apo nga botues të dyshimtë.
- Nuk janë nga revista vendore
- Nuk janë komunikime të shkurta

Analiza dhe kategorizimi

Është realizuar analizë statistikore sipas:

- Fakultetit, titullit akademik dhe gjinisë
- Është përllogaritur mesatarja e publikimeve për çdo anëtar të stafit dhe veçmas për profesorët.
- Është analizuar e vlefshmëria e punimeve për avancim akademik bazuar në rolin e autorit (i parë ose korrespodent) dhe nëse janë botuar në revista të indeksuara në Web of Science ose në Scopus në kohën e publikimit.

Analiza e justifikimit të titujve

Ndonëse rregullorja e Universitetit të Ferizajt njeh vetëm autorin e parë për qëllime të avancimit akademik, për analizë është aplikuar ky standard:

- **Profesor i rregullt**: të paktën 5 punime si autor i parë ose korrespodent.
- **Profesor i asocuar**: të paktën 3 punime si autor i parë ose korrespodent.
- **Profesor asistent**: të paktën 1 punim si autor i parë ose korrespodent.

Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim